



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 348 Prot.

Vlorë, më 19.02. 2026

PROJEKTVENDIM

“PËR DHËNIEN E MANDATIT TË KËSHILLTARIT Z.VALTER MURAT HASANAJ”

Bazuar në Ligjin Nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 49, pikat 1,2 dhe 3, në Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë”, si dhe në shkresën Nr 307 Prot, datë 04.02.2026, dhe Vendimin e KQZ Nr 10, datë 03.02.2026 , si dhe në Raportin e Komisionit të Mandateve dhe Rregullores të Këshillit të Bashkisë, datë .02. 2026 , Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës .02.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e mandatit të këshilltarit, anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë, Z.Valter Hasanaj.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretariati dhe Këshilli i Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë, sipas Ligjit Nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 55, pika 6.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

RELACION
MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR DHËNIEN E MANDATIT TË KËSHILLTARIT
Z.VALTER MURAT HASANAJ”

Para Këshillit të Bashkisë!

Të nderuar Këshilltarë!

Projektvendimi “Për dhënie e mandatit të këshilltarit z.Valter Murat Hasanaj”, lidhet me VKB Nr 103, datë 23.12.2025, “Për mbarimin para afatit të mandatit të këshilltarit Ilir Servet Aliaj”.

Nga ana e Sekretariatit të Këshillit, vendimi i sipërcituar, së bashku me kërkesën për dorëheqje, i është përcjellë KQZ-së.

KQZ, me shkresën Nr 307 protokoll, datë 04.02.2026, ka vënw në dijeni Këshillin e Bashkisë Vlorë, për Vendimin Nr 10, datë 03.02.2026 “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vlorë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z.Valter Murat Hasanaj”. Ndërkohë, Komisioni i Mandateve dhe i Rregullores së Këshillit të Bashkisë, ka përgatitur raportin përkatës, për vlefshmërinë e mandatit të këshilltarit, për zotin Valter Hasanaj.

Nga sa më lartë, kërkojmë të miratohet projektvendimi “Për dhënie e mandatit të këshilltarit z.Valter Murat Hasanaj”,

Duke ju falënderuar.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 04/02/2026

Nr. 307

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

Drejtuar: **Këshilli i Bashkisë Vlorë** ✓
Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë

Partisë Socialiste të Shqipërisë
Sheshi "Austria", Nr.91, Tiranë

Z. Valter Murat Hasanaj
Radhimë, Orikum, Vlorë

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 03.02.2026, mori në shqyrtim projektvendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Vlorë. Pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Vlorë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", z. Valter Murat Hasanaj".

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin me nr. 10, datë 03.02.2026.

Duke ju falënderuar,

Sekretar i Përgjithshëm

(në mungesë dhe me urdhër)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 3.2.2026

Nr: 10

Ora: 12:00

VENDIM
PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË VLORE ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË", Z. VALTER MURAT HASANAJ

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 20006/1 prot., datë 29.12.2025, Këshilli i Bashkisë Vlorë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Ilir Servet Aliaj, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", për Këshillin e Bashkisë Vlorë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 34, z. Valter Murat Hasanaj.

Me shkresën nr. 68, prot., datë 08.01.2026, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë, z. Valter Murat Hasanaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Data: 3.2.2026 Nr: 10
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vlorë me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", z. Valter Murat Hasanaj".

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit "Partia Socialiste e Shqipërisë" ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër VL-PS-3972 1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Valter Murat Hasanaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për z. Valter Murat Hasanaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar të z. Valter Murat Hasanaj, në Këshillin e Bashkisë Vlorë.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Valter Murat Hasanaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Valter Murat Hasanaj, në Këshillin e Bashkisë Vlorë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vlorë, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", z. Valter Murat Hasanaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



Data: 3.2.2026 Nr:10
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vlorë me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", z. Valter Murat Hasanaj".